

MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE
ENERGJETIKES

DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSEHM

RAPORT PERFUNDIMTAR

NE

“SEKRETARIATI I NISMES PER
TRANSPARENCE NE INDUSTRIE
NXJERRESE “

(ALBEITI)

T I R A N E

AUDITIM I PLOTE

PER PERIUDHEN : 21.12.2010 – 30.09.2011

JANAR 2012

RAPORT PERFUNDIMTAR I ANGAZHIMIT TE
AUDITIMIT
NE
“ SEKRETARIATI I NISMES PER TRANSPARENCE NE
INDUSTRINE NXJERRESE ”

Permbledhje Ekzekutive .

Ne zbatim te planit vjetor te auditimit te brendshem dhe te Programit te Angazhimit te Auditimit Auditimit me nr. 8541/2 prot, date 02.12.2011 , prej dates 01/12/2011 deri me 22.12.2011, prane “**Sekretariati i Nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrese** “, u krye auditimi i plote ne baze sistemi me objekt: ” Rregullshmeria e krijimit dhe funksionimit, zbatimi i ligjshmerise dhe rregullshmerise financiare ne perdorimin e fondeve, vleresimi i sistemeve te veprimtarise dhe dhenie e rekomandimeve. ”, per periudhen ushtrimore **21.12.2010 deri me 30.11.2011.**

Grupi i punes i ngarkuar per kryerjen e ketij auditimi perbehej nga Josif Lubonja , Inspektor i I-re Auditimit .

Metoda dhe teknika e perdorur : Auditim ne baze sistemi, me ekzaminim dhe rishikim analitik nepermjet sondazheve dhe spontimit.

Grupi i auditimit me daten 22.12.2011 perpiloj Projekt Raportin e Angazhimit dhe ja dergoi zyrtarisht entitetit me shkresen nr. 8541/4, date 22.12.2011. Me daten 04.01.2012 midis paleve u krye takimi perfundimtar per diskutimin e problemeve dhe planin e veprimit per rekomandimet paraprake te trajtuara ne Projekt Raport. Subjekti me shkresen nr. 148/1, date 03.01.2012, prot. hyrje 11.01.2012, dergoi Projekt Raportin e Auditimit te firmosur si dhe verejtje dhe raportim masash mbi draft raportin e auditimit .

Koha e auditimit, ka perfshire kohen per investigimin paraprak dhe njohjen me subjektin, hartimin e programit dhe kryerjen e auditimit si dhe te pergatitjes se raporteve, deri ne dergimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve perkatese prane subjektit te audituar.

Hyrje.

Sekretariati i Nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrese, eshte krijuar me VKM Nr.540, date 07.07.2010 “*Per ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit, per ndjekjen e procedurave te anetaresimit te Shqiperise, si vend zbatues, ne nismen per transparence ne industrine nxjerrese*”, si dhe VKM Nr. 975, date 01.12.2010 “*Per nje ndryshim ne VKM 540, date 07.07.2010* “, dispozita ne te cilat eshte percaktuar statusi i ketij entiteti, misioni, objektivat e tij, format e financimit, format dhe nivelet e raportimit.

Misioni i entitetit : realizimi i hapave te anetarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), dhe pas këtij anetarësimit, përgatitja e raporteve vjetore deklarimit te te ardhurave, në bashkëpunim me Grupin Ndërinstitucional të Punës.

Statusi ekonomik, fillimisht eshte percaktuar me VKM 540, date 07.07.2010 si institucion buxhetor dhe me pas ndryshuar me VKM Nr. 975, date 01.12.2010, eshte percaktuar "ent publik".

Burimet e financimit, percaktuar ne dispozitat e krijimit, jane fonde :

- nga buxheti i shtetit;
- te institucioneve nderkombetare, te destinuar per programin EITI;
- nga subjekte fizike ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe te huaj.

Gjetjet nga auditimi.

1. Organizimi dhe funksionimi i entitetit, ALBEITI.

Per periudhen e audituar evidentohet se entiteti, ***Sekretariati i Nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrese***, eshte organizuar konforme struktures organizative dhe organikes te percaktuar dhe miratuar me Urdherin Nr. 896, date 21.12.2010, ndryshuar me Urdherin Nr. 530, date 18.07.2011, te Ministrit te METE.

Drejtues i Sekretariatit, eshte emeruar me Urdherin e Kryeministrit me Nr. 201, date 03.12.2010, z. Shkelqim HYSAJ, ne perputhje me kerkesat e pikes 9 te VKM 540, date 07.07.2010.

Funksionimi i strukturave, ne realizim te detyrave dhe objektivave te saj.

Evidentohet se stafi i ***Sekretariatit te Nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrese***, per periudhen objekt auditimi, ne kuader te ndjekjes te procedurave te anetaresimit te Shqiperise si vend zbatues ne nismen per transparence ne Industrine nxjerrese, ka pergatitur programin e punes ne realizim te objektivave, dhe ka kordinuar programin e veprimeve per ceshtjet e EITI sipas afateve te caktuara per vitin 2009-2011 dhe vecanerisht per vitin 2011 si dhe ne baze te rekomandimeve te grupit te vleresues te EITI, eshte hartuar program pune 3 vjecar, 2011-2013, per proceset dhe punen e EITI ne Shqiperi, si dhe percaktuar objektivat per tu realizuar.

Stafi i sekretariatit ka bashkerenduar ne vazhdimesi dhe raportuar ne menyre periodike, mbi punen e bere dhe aktivitetin e tij, ne mbledhjet e Grupit Nderinstitucional te Punes, te ngritur me VKM 156, date 27.12.2008, konforme dhe ne zbatim te detyrave te percaktuara ne piken 6 dhe 12 te VKM me nr.540 date 7.7.2010 "Per ngritjen dhe funksionimin e sekretariatitALBEITI ".

Gjate kesaj periudhe, eshte realizuar raporti i pare me EITI, ku eshte realizuar perzgjedhja e administratorit te pavarur, kompania e huaj Fair-Links. Gjithashtu eshte realizuar Raporti Vleresues EITI per Shqiperine, nga kompania Angleze Hart Group.

"ALBEITI", ka programuar punen, ne zbatim te planit 3 vjecar 2011-2013 si dhe rekomandimeve te lena, ka punuar per permiresimin e rregulloreve dhe procedurave te grupit te punes, hartimit dhe miratimit te memorandumeve me kompanite hidrokarbure, si dhe programimeve dhe realizimit te seminareve dhe workshope-ve me grupet e punes, grupet e interesit, shoqerine civile dhe komunitetin ne zonat e industrise nxjerrese.

Nga ana e Drejtuesit te Sekretariatit dhe Kordinatoreve, jane pergatitur materiale raportuese dhe materiale per ndjekjen e procedurave dhe realizimin e programit te veprimeve, respektivisht per 11 mbledhje te Grupit Nderinstitucional te Punes, te zhvilluara nga data 04.01.2011 deri ne 08.11.2011, mbledhje ne te cilat nga Grupi i Punes jane marre vendimarrjet perkatese per cdo problem te trajtuar.

Eshte raportuar periodikisht, *konforme kerkesave te percaktuara ne piken 6 dhe 12 te VKM me nr.540 date 7.7.2010 "Per ngritjen dhe funksionimin e sekretariatitALBEITI "*, me informacion me shkrim per Kryeministrin, mbi ecurine dhe realizimin e programit te veprimeve dhe objektive te sekretariatit, si dhe per probleme te vecanta eshte raportuar eshte per Ministrin e METE, dhe derguar informacione "mbi vendimin e Bordit te EITI per shqyrtimin e kandidatures per anetaresimin e Shqiperise si vend ne EITI " dhe " mbi ecurine e projektit " Nisma per transparence ne Industrine nxjerrese per 9 mujorin 2011".

Nga ana e Kordinatoreve te ALBEITI, ne realizim te detyrave funksionale dhe objektive te entitetit, jane pergatitur dhe raportuar perpara Drejtorit te Sekretariatit ,ne menyre periodike materiale ku perfshihen raporte, analiza, studime, informacione per ndjekje operative te problemeve, prezantime per trajtime , analiza per ndjekjen e fondeve buxhetore dhe fondeve te projektit te Bankes Boterore .

- Organizimi i kontrollit te brendshem ne entitet.

Sipas kerkeses te pikes 11 te VKM 540, date 07.07.2010 dhe pikes 5 te Urdherit Nr. 896 date 21.12.2010 te Ministris te METE, ndryshuar me Urdherin Nr. 530, date 18.07.2011 te Ministris te METE, evidentohet se per realizimin e objektive dhe detyrave funksionale te stafit organizativ, si element i organizimit te kontrollit te brendshem, eshte bere ndarja e detyrave per cdo pozicion dhe emertim te struktures dhe eshte pergatitur draft Rregullorja e Brendshme e Sekretariatit ALBEITI.

Evidentohet se draft Rregullorja e Brendshme, eshte derguar ne METE, per miratim me shkresat nr. 102 date 02.08.2011 si dhe me shkresen nr. 102/2 date 23.09.2011, por deri ne momentin e kryerjes te auditimit evidentohet se ne entitet nuk ka ardhur nga METE miratimi i Rregullores te Brendshme te Funksionimit te ALBEITI dhe detyrave funksionale sipas emertimeve te struktures organizative te miratuar.

Auditimi vlereson se ne entitet eshte punuar per te krijuar sistemin e kontrollit te brendshem, jane percaktuar nivelet e kontrollit dhe te raportimit te realizimit te detyrave funksionale, si dhe eshte vleresuar risku i mundshem ne cdo nivel te struktures organizative.

Auditimi vlereson se ne organizimin e kontrollit te brendshem jane patur parasysh dhe jane respektuar elementet e mos pasjes konflikt te funksioneve, ne kryerjen e detyrave funksionale nga hallkat e struktures organizative te ALBEITI-t.

2. Per perdorimin e fondeve buxhetore dhe donacioneve nga te tretet.

Mbi celjen dhe perdorimin e Fondeve Buxhetore.

Nga investigimi i dokumentacionit te celjes te fondeve buxhetore, evidentohet se : Celja e fondeve buxhetore nga METE per ALBEITI , eshte bere percaktuar per llogarine ekonomike

230 per shpenzime kapitale , dhe me destinacion kod projekti M040156. Miratimi i bere me me shkresen 548/2 date 8.2.2011, nuk ka strukture detajim dhe ndarje fondi ne grupet e tjera dhe llogarite ekonomike sipas klasifikimit buxhetor, per pagat, sig shoqerore, shpenzime te tjera, etj , por vetem per llogarine 230 per shpenzimet kapitale.

Mbi perdorimin e fondeve buxhetore.

Entiteti ka evidentuar perdorimin e fondeve buxhetore , per periudhen e vitit 2011, dhe ka rakorduar me Degen e Thesarit Tirane, per perdorimin e tyre. Pasqyrat e rakorduara me degene thesarit jane te firmosura dhe vulosura rregullisht nga pale.

Perdorimi i fondeve buxhetore per vitin 2011 deri ne daten 30.11.2011, eshte realizuar ne total per 4.684.540 leke dhe ndare sipas artikujve , paraqitet :

Per shpenzime paga e sig shoqerore (llog 600 +601), ne shumen 4.067.228 leke

Shpenzime te tjera operative (llog 602), ne shumen 617.312 leke.

Shpenzime kapitale (llog 230 + 231), ne shumen 0 leke.

Auditimi vlereson se ne totalin e shpenzimeve te entitetit , peshen specifike me te madhe e zene shpenzimet per sherbime *per pagat dhe sigurimet shoqerore e shendetsore, te cilat per tere periudhen 11 mujore kapin vleren per 4.067.228 leke ose 86.8 % te totalit te shpenzimeve per kete periudhe 11 mujore, ndersa shpenzimet per mallra e sherbime kapin vleren 617.312 leke ose 13.2 % te totalit te shpenzimeve per kete periudhe. Evidentohet se entiteti nuk ka kryer dhe evidentuar shpenzime per investime kapitale , qe i perkasin grupit 230 + 231.*

Ne analize te shpenzimeve te Grupit 602.

Ne totalin e shpenzimeve per grupin 602 , peshen specifike me te madhe e zene vetem dy zera shpenzimesh, ato te kryera per riparime e meremetime zyrash , te cilat per kete periudhe kapin vleren 332.800 leke ose 53.9 % te shpenzimeve totale te ketij grupi, dhe me pas shpenzimet per blerje karburanti per vleren 212.400 leke ose 34.4 % te totalit te shpenzimeve te ketij grupi.

Ne analize te realizimit te shpenzimeve sipas grupeve, nengrupeve dhe zerave sipas destinacionit, evidentohet se per periudhen e audituar , shpenzimet e realizuara nga entiteti, nuk jane ne perputhje me grupin dhe kategorine ekonomike te shpenzimit, sipas miratimit te fondeve nga buxheti i shtetit, me shkresen nr. 11030/2, date 10.01.2011 dhe me shkresen 548/2 date 8.2.2011 .

Fondet e celura nga burime financiare te destinuar per programin, nga institucione nderkombetare. Perdorimi i tyre.

Per periudhen objekt auditimi, evidentohet se , me VKM Nr. 514 , date 30.6.2010 eshte vendosur miratimin, ne parim, i marreveshjes se grantit nr. TF 096009, ndermjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Mbështetja e zbatimit të iniciativës së

transparencës, për industrinë nxjerrëse (EITI)”, me një grant prej 275.000 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) USD.

Granti rezulton se është mbështetur në marrëveshjen e lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Mbështetja e zbatimit të iniciativës së transparencës, për industrinë nxjerrëse (EITI)”, të datës 9.8.2010.

Marrëveshja përmban ndër çështjeve të tjera dhe problemet e financimit të fondeve, përcaktuar për shumën totale per 275.000 USD, me destinacion për projektin ID nr.P116632 (grand Nr. TF 096009, i ndarë në dy kategori shpenzimesh : a) mallra, shërbime konsulence, kontrolli dhe trajnime për vlerën 228.000 USD dhe b) kosto operative për 47.000 USD.

Evidentohet se të dy grupet e shpenzimeve , rezultojnë të detajuara sipas planit të shpenzimit për zerat përkatës dhe kategorive të njesive, plan shpenzimesh i cili rezulton i miratuar fillimisht në datën 18.3.2011 dhe më pas në datat 6.10.2011 si dhe në datë 19.10.2011, nga drejtuesi i projektit si dhe është marrë miratimi nga ana e bankës (IBRD).

Për përdorimin e fondeve, përcaktuar në planin e shpenzimeve, me bankën (IBRD), jane bërë korespondencat përkatëse dhe zbatimi i procedurave sipas përcaktimeve në marrëveshjen e lidhur.

Për realizimin e kërkesave dhe nevojave të entitetit ALBEITI, sipas termave të referencës, janë marrë fillimisht konfirmimet nga drejtuesi i projektit, dhe më pas janë realizuar procedurat e prokurimit të fondeve.

Per periudhën e audituar evidentohen të kryera këto procedura prokurimi realizuar dhe financuar me Bankën Botërore :

Shërbim konsulence për përzgjedhjen e firmës si administrator i pavarur për përgatitjen dhe bashkërendimin e raportit të parë EITI, vlera e kontraktuar për **85265 USD, firma fituese** Firma "Fair Links SARL",France.

Modem Wireless W3000 (2Cope), për vlerën **6600 leke, firma fituese** Albtelcom sh.a.

Konsulence financiare, për vlerën e kontraktuar **3000 USD, me zj.** Etleva Alushi, person fizik.

Pajisje Elektronike, për vlerën e kontraktuar **29400 USD , firma fituese** BNT Electronica.

Blerje dhe montim grilash, për vlerën e kontraktuar **50400 leke, firma fituese** Aral sh.p.k.

Shërbim konsulence për përgatitjen e strategjisë së komunikimit dhe planit të veprimit për zbatimin e Nismës së Trasparencës në Industrinë Nxjerrëse EITI, për vlerën e kontraktuar **7070 USD, me zj.** Diana Kalaja , person fizik.

Përgatitja dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare të webit të sekretariatit EITI, për vlerën e kontraktuar **2200 USD , firma fituese** Suad Barbullushi Nipt:K91628003T.

Blerje dhe montim kondicioneresh, për vlerën e kontraktuar **1530 USD , firma fituese** MIELE Electromagic sh.p.k.

Mobilim zyresh, për vlerën e kontraktuar **22597.20 USD , firma fituese** Home Décor tirana sh.p.k .

Blerje Kancelarie, për vlerën e kontraktuar **475175 leke , firma fituese** Euro-Office Nipt:K31803032W.

Nga ana e kordinatorit ekonomik, eshte bere ndjekja e vazhdueshme e praktikave dhe procedurave per realizimin e projektit dhe prokurimin e fondeve si dhe raportimi periodik .

Per perdorimin e fondeve, me situacion raportimi eshte raportuar nga Sekretariati ALBEITI , prane Ministrise se Financave, me shkresat nr. 125 date 4.10.2011, me nr. 131 date 2.11.2011 dhe te fundit me shkresen nr. 143, date 05.12.2011.

Per grandin e akorduar prej 275 000 USD per projektin ID Nr.P116632 (grand Nr. TF 096009). evidentohet se per periudhen e audituar, deri ne daten 30.11.2011 , situata e fondeve te disbursuara dhe te perdorura , paraqitet :

Fonde te disbursuara deri ne daten 30.11.2011, total 198.223,86 USD

Fonde te shpenzuara deri ne daten 30.11.2011, total 159.823,46 USD

Ne analize sipas atikujve

600 shp.pagat. 12.209,33 USD

602 shpenzime te ndryshme 7.573,73 USD

230 konsulente per projektin 95.434,4 USD

231 paisje e orendi 44.606 USD

Fondet evidentohet se jane levruar dhe perdorur nepermjet transaksioneve per celjet me Banken e Shqiperise nepermjet llogarise 2117458U, dhe bankes te nivelit te dyte Credins Bank nepermjet te llogarise per veprime me USD me nr. 00000274014 .

Per perdorimin e fondeve , dhe transaksionet e kaluara nepermjet Credins Bank, jane marre konfermat bankare periodike per pagesat e kryera, dhe tepricat ne llogari per fund periudhen raportuese. Evidentohet se sipas konfermes bankare te dates 5.12.2011 te Credins Bank per nr llogarie 00000274014 , ne USD, teprica per daten 1.12.2011 eshte konfirmuar per shumen 38.400,40 USD, teprice e cila rakordon me raportimet e bera nga entiteti per METE dhe Min e Financave.

- Evidentohet se me urdherin Drejtorit te Sekretariatit z. Sh.Hysaj , me nr. 84/1 date 19.9.2011 “ Per nderprerje kontrate “, eshte urdheruar nderprerja e kontrates, me Ref EITI/IC/Nr.3 date 23.4.2011 te lidhur me zj. Etleva Alushi, per konsulencen financiare, per arsye se konsulentja duke filluar nga muaji Qershor 2011 e ne vazhdim ka lidhur kontrate me nje projekt tjeter te Bankes Boterore

Sipas konfermes bankare te Credins Bank te dates 23.9.2011, evidentohet se ne llogarine bankare me nr. 00000274014, jane derdhur nga zj. E.Alushi vlere prej 600 USD, veprim i kryer me urdher xhirim te brendshem ne daten 21.9.2011 me urdherues E.Alushi per rikthim page qershor –korrik per shumen 600 USD.

Per periudhen objekt auditimi, supervizimi financiar i procedurave dhe perdorimit te fondeve te ketij projekti , eshte kryer nga nje grup supervizoresh financiar te Bankes Boterore, i perbere nga zj. Ida Njeri Muhoho , specialiste e larte e menaxhimit Financiar dhe zj. Jonida Myftiu Specialiste e menaxhimit financiar, si dhe zj. Benedicta T.Olivaros specialiste prokurimi, te cilat kane kryer misionin e supervizimit financiar ne daten 24.10.2011 prane entitetit Sekretariati i Nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrrese. Evidentohet se deri ne momentin e kryerjes te ketij auditimi, raporti dhe konkluzionet e auditimit nga ky grup nuk jane paraqitur akoma ne entitet.

Donacione nga subjekte fizike e juridike, rregullshmeria e perdorimit te tyre.

Per periudhen objekt auditimi, evidentohet se Shoqeria "Albpetrol" sha Patos, mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" ka financuar Sekretariatin e Nismes per Transparence ne Industrine Nxjerrrese (ALBEITI), per shumen prej 9.100.000 leke, me destinacion per ndjekjen e procedurave te anetaresimit te Shqiperise strukturen nderkombetare te EITI.

Marrja e ketij donacioni, rezulton se eshte mbeshtetur ne Urdherin e Ministrit te METE me Nr. 267 date 31.03.2011, " Per Financimin e Sekretariatit(EITI) ", ku eshte percaktuar : Financimi nga sha Albpetrol, Patos, te shumes prej 9,1 milion leke per Sekterariatin ALBEITI.

Evidentohet se fondi eshte rimbursuar ne llogarine e ALBEITI per shumen 9.100.000 leke, ne daten 8.4.2011.

Per perdorimin e ketij fondi nga entiteti ALBEITI jane kryer keto procedura prokurimi :

a. Sherbim konsulence per vleresimin e raportit te pergatitur nga vleresuesi i pavarur EITI, per vlere te kontraktuar per **8713245 leke, fituese** Kompania Hart Group U.K. Lic. Nr. 05184339 (procedure e realizuar nga METE).

b. Workshop me median, per vleren **54600 Leke, ne** Hotel Diplomat HY" NiptJ61814106E.

Per sherbimin e konsulences per perzgjedhjen e konsulentit per raportin e vleresimit pergatitur nga nje vleresues i pavarur qe do te asistojte procesin per ndjekjen e procedurave te anetaresimit te Shqiperise , si vend zbatues, ne nismen per transparence ne industrine nxjerrrese, rezulton se nga palet METE e perfaqesuar Sekretariati EITI, Drejtori z. Sh.Hysaj dhe shoqerise " HART NURSE " (me emer tregtar Hart Group) U.K., perfaqesuar nga z. David Quinn, perpara noterit Arian Merkuri , eshte lidhur Kontrata e Sherbimit e dates 31.03.2011, me nr. 1290 Rep. dhe nr. 415/1 Kol., nenshkruar rregullisht.

Kontratata eshte nenshkruar nga z. Sh.Hysaj, mbeshtetur ne shkresen e METE me nr.1229/3 date 07.03.2011 " Autorizim per lidhje kontrate ", mbas tenderit te kryer ne METE ne baze te Urdherit te Ministrit nr.4 date 5.1.2011 dhe urdher prokurimit nr.82 date 9.2.2011.

Per perdorimin e fondit evidentohet se transaksionet financiare jane kryer nepermjet llogarise rrjedhese ne Leke (ALL) me nr. 0280355 ne Credins Bank .

Auditimi evidenton se per transaksionet e kryera nepermjet Credins Bank per perdorimin e fondeve te celura nga donatori AlbPetrol sh.a., dhe administruar nga ALBEITI ne llogarine nr.280355, eshte rakorduar me banken dhe eshte marre periodikisht konfirmimi i veprimeve te kryera. Sipas konfirmes te veprimeve ne kete llogari, te leshuar nga Credins Bank, **ne daten 14.12.2011 teprica e gjendjes ne llogari rezulton per shumen 574.016,83 leke.** (llogaria kredituar ne total fond i celur dhe interesa te perfituara, per 9.107.781,66 leke dhe debituar ne total , pagesa te kryera dhe komisione , per 8.533.764,83 leke.

(Per perdorimet e fondeve, dokumentacionin justifikues mbeshtetes dhe problematikat eshte relatuar ne menyre te detajuar ne projekt rapportin e auditimit.)

3. Administrimi i vlerave materiale dhe monetare.

a). Mbi respektimin e rregullave per administrimin e vlerave materiale, konstatohet se :

Entiteti ka te miratuar strukturen organizative me pozicion per specialist arkiv, protokoll, magazine , me detyra funksionale per administrimin e vlerave materiale.

Evidentohet se fillimisht me detyren e magazinjeres eshte emeruar zj. Erisa Xhelilaj , me Urdherin e Drejtorit nr. 3 date 17.01.2011 punonjese e cila ka qene ne kete detyre deri ne daten 15.6.2011.

Me Urdherin me nr. 49 date 16.6.2011 te Drejtorit te Sekretariatit, eshte urdheruar qe specialisti i IT, z. Erlin Hajdini, te kryeje perkohesisht edhe detyren e magazinjerit dhe specialistit te arkive , protokoll , deri ne emerimin e punonjesit qe do te kryeje kete detyre.

Per periudhen objekt auditimi, entiteti per evidentimin e vlerave materiale si dhe per qarkullimin e tyre, ka mbajtur dokumentacion per evidentimin e hyrjeve dhe daljeve si dhe librin e kartelave te artikujve te inventarit ne magazine, te cilat evidentohet se jane mbajtur te grupuara per grup artkujt ; a) kancelari e shtypshkime , b) paisje elektronike dhe IT, c) orendi e paisje zyre.

-Entiteti ka administruar materialet orendi e paisje zyresh dhe mjete pune te blera me fondet nga institucionet nderkombetare, si dhe marre transferim kapital nga METE ne momentin e krijimit, te cilat evidentohet se ne total jane per 44 artikuj, per vleren totale 5.640.052,17 leke . (ku mjete klasifikuar ne inv. ekonomik per 2.095.722 leke dhe mjete klasifikuar ne makineri e paisje per 3.544.330,17 leke.)

-Entiteti ka realizuar gjate periudhes objekt auditimi , blerje te artikujve te imet , koncelari e shtypshkrime , per vleren totale 475.175 leke.

-Entiteti ka realizuar gjate periudhes objekt auditimi , blerje karburanti ne tollona per sasine 1200 litra per vleren 212.400 leke.

ALBEITI , disponon asete : ne 31.11.2010

Aktive Afatgjata te Patrupezuara

230 inst progr inf financiar 120.000 leke

Aktive Afatgjata te Trupezuara

ku : 214 mak.paisje, mjete pune 3.544.330,17 leke (nga keto gjendje ne magazine per vleren 629.535,48 leke)

215 Mjete transporti 0

214 Inventar ekonomik 2.095.722 leke (nga keto gjendje ne magazine per vleren 629.535,48 leke)

Aktive afatshkurtera, llog 31.

Inventari imet ne magazine 426.495 leke

Karburant ne tollona 212.400 leke

Auditimi evidenton se ne entitet, eshte krijuar sistem per evidentimin dhe administrimin e vlerave materiale nepermjet magazines dhe aseteteve pasuri te entitetit, dhe eshte plotesuar dokumentacioni i inventarit personal te cdo punonjesi per orendite , paisjet dhe mjetet e punes qe ka ne ngarkim.

b). Rregullshmeria e inventarizimit fizik te vlerave materiale. Procedurat per nxjerrjet jashte perdorimit dhe asgjesimin e materialeve.

Per verifikimin te asetave pasuri te entitetit, evidentohet se deri ne momentin e kryerjes te ketij misioni auditimi, akoma nuk eshte organizuar sistemi i verifikimit fizik dhe inventarizimit te vlerave materiale ne magazine dhe i atyre sipas kartelave personale te cdo punonjesi.

Sistem i cili eshte i domosdoshem per te realizuar me sukses dhe konforme kerkesave te Ligjin nr.9228, date 29.4.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", te ndryshuar si dhe VKM Nr.783, date 22.11.2006 " Per percaktimin e standarteve dhe te rregullave kontabel", raportimin e pasqyrave financiare te asetave pasuri e entitetit EITI-se, per fund vitin 2011.

Mbi administrimin e karburant lubrifikanteve .

Nga auditimi evidentohet se entiteti nuk ka mjet te rregjistruar ne asetet e tij dhe nuk ka as mjet te vene ne perdorim nga organi epror METE.

Auditimi evidenton se entiteti ka realizuar blerje karburanti Benzine, per sasine 1200 litra , ne tollona, ne subjektin shites Kastrati shpk, sasi e cila eshte bere hyrje ne magazine me flete hyrjen nr.10 date 22.11.2011, dhe nga investigimi i bere ne momentin e ketij auditimi rezulton gjendje e pa konsumuar ne magazine per 1200 litra.

Per periudhen objekt auditimi, nuk eshte shpenzuar sasi karburanti, per rrjedhoje nuk u investigua mbi rregullshmerine e procedures dhe dokumentacionit te mbajtur per kete qellim.

Mbi shpenzimet per perdorimin e telefonave celular.

Auditimi evidenton se, per periudhen objekt auditimi , u njihen si shpenzime mujore te perdorimit te telefonave celulare , vetem 4 punonjesve qe jane Drejtori i Sekretariatit z. Sh. Hysaj per nivelin e shpenzimit deri ne 10.000 leke , kordinatoret A.shehu dhe A.Brojka per nga 5000 leke seicili, Pergj.Sekt Mbeshtetes per 5000 leke ne muaj, kjo e percaktuar per mbulimin e shpenzimeve eshte pranuar te behet nga fondet e grandit nderkombetar te projektit EITL, planifikuar ne planin e shpenzimeve te ketij programi ne kategorine Operationg Cost te analizuar dhe pranuar nga drejtori i projektit.

Per periudhen objekt auditimi deri ne 31.11.2011 nuk eshte kryer asnje likujdim i faturave dhe mbulimit te shpenzimeve.

Auditimi evidenton se ne percaktimin e kuotave per perdorim telefoni dhe per tu mbuluar me fondet e grandit te projektit , nuk eshte patur parasysh dhe nuk eshte vepruar ne perputhje me VKM nr.864 date 23.07.2010 "Per paisjen me numer telefoni celular te personave juridike, publik ", lidhur me kuoten e percaktuar per vleren e sherbimit te telefonise celulare qe duhet perballuar nga institucioni per personat juridike, publike, edhe per njesite qe kane fonde speciale, mbasi dispozitat percaktojne :

Ne VKM nr.864 date 23.07.2010, pika 9 dhe pika 12 percaktojne qe kuota qe perballohet nga shpenzimet e buxhetit te entitetit apo njesite me fonde speciale, per kategorine e punonjesve me page II-b, eshte deri 4000 leke, nderkohe qe per punonjesit e Sekretariati eshte percaktuar kuota per 5000 leke.

Drejtuasi i njesive me fonde speciale kane te drejte te urdherojne paisjen me numer telefoni celular te personave zyrtare , bazuar ne detyren qe kryejnesipas specifikimeve te mesiperme. (percaktuar ne pikat 1 deri 9 te VKM 864 date 23.7.2010).

4. Auditim i veprimeve dhe operacioneve me likuiditetet.

Evidentohet se Entiteti ka aplikuar per periudhen objekt auditimi vetem transaksione nepermjet bankes.

Azhornimi i pagesave me dokumentacionin kontabel justifikues.

Nga investigimi i transaksioneve te kryera evidentohet se veprimet jane të mbeshtetura me dokumentacionin justifikues dhe urdheruese. Per cdo rast eshte bere ciftezimi i dokumentave te thesarit dhe te bankes me urdher shpenzimin, faturat tatimore , kerkese urdher xhirimin , fletehyrje te magazines e dokumenta te tjere justifikues per veprimet e bera me procedure te blerjeve me vlera te vogla.

Urdher shpenzimet rezultojne te plotesuara konforme formatit te ketij dokumentacioni per veprimet me degen e Thesarit, miratuar nga Ministria e Financave me shkresen nr. 6153 date 27.5.2009. Ky dokumentacion rezulton i ploesuuar dhe firmosur rregullisht nga titullari dhe finacierja e ALBEITI dhe ne te gjitha rastet eshte marre aprovimin e Dreges se Thesarit te zyrtarizuar me vulen perkatese.

Per periudhen objekt auditimi jane likuiduar nepermjet bankes me thesarin edhe blerje te realizuara me procedurat e blerjeve me vlera te vogla, ku nga investigimi mbi rregullshmerine e procedurave te realizuara dhe dokumentacionit mbeshtetes , rezultoi se :

- Drejtori i entitetit, kryetar i autoritetit kontraktor, per realizimin e procedurave per blerjet me vlera te vogla ka ngritur ne fillim te vitit kalendarik, komisjonin perkates me Urdherin nr.5, date 25.2.2011, konforme kerkesave te *Udhezimit te Keshillit Ministrave me nr.2, date 18.2.2008 " Mbi proceduren e prokurimit me vlera te vogla "*.
- Per cdo rast procedure, titullari ka nxjerre Urdherin e Prokurimit, per miratimin e kryerjes sherbimit apo blerjes artikujve .
- Praktikat jane shoqeruar fillimisht me kerkesen per nevojen dhe domosdoshmerine e sherbimit apo blerjes.
- Per cdo praktike blerje, komisioni ka mbajtur proces verbalet nr.3 dhe nr.4, per evidentimin e ofertave dhe percaktimin e ofertes me te ulet dhe subjektin ku do te kryhet blerja. Jane plotesuar rregullisht nga komisjonet proces verbalet e mesiperme per cmimet dhe fituesin dhe 2 anetaret qe do te realizojne blerjen.
- Materialet dhe artikujt e blere , jane shoqeruar me faturen e shitesit dhe jane bere hyrje ne magazinene e entitetit me dokument hyrje te rregullt.

- Gjate periudhes te audituar nuk ka patur raste te kryerjes te procedurave per blerje me vlera te vogla per amergjence.

- Nga Autoriteti Kontraktor nuk eshte kaluar limiti i percaktuar per vleren 400.000 leke ne vit per blerje sherbime apo artikuj te te njejtes natyre, percaktuar ne piken 1 te udhezimit te Keshillit Ministrave me nr.2 date 18.2.2008 "Mbi proceduren e prokurimit me vlera te vogla "

